

## **Thirrje për propozime projektsh standarde nën programin Interreg IPA Adriatiku Jugor 2021-2027**

Është shpallur thirrja për projekte standarde shumëpalëshe nën programin Interreg IPA Adriatiku Jugor 2021-2027 (Interreg IPA South Adriatic).

Interreg IPA Adriatiku Jugor është një program trepalësh i bashkëpunimit ndërkufitar, që bashkëfinancohet nga Bashkimi Evropian nën Instrumentin për Asistencën e Para-Aderimit (IPA III) për periudhën e programit 2021–2027.

Kjo thirrje synon të financojë projekte që adresojnë sfidat e përbashkëta territoriale midis Italisë, Shqipërisë dhe Malit të Zi, që të kontribuojnë në arritjen e objektivave specifike të programit.

**Temat e thirrjes janë të ndarë në 4 Prioritete të Programit dhe 7 Objektiva Specifike:**

### **Smart**

1.1. NVM-të, veprimet do të synojnë përmirësimin e kushteve të kornizës për rritjen dhe konkurrencën e NVM-ve, përfshirë mikro NVM-të.

### **Green**

2.1 Rreziqet, veprimet do të synojnë promovimin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimin e rrezikut dhe qëndrueshmërinë ndaj fatkeqësive.

2.2. Biodiversiteti, veprimet do të synojnë rritjen e biodiversitetit, infrastrukturës së gjelbër në mjedisin urban, dhe reduktimin e ndotjes, përfshirë ndotjen e ujit, tokës dhe ajrit (si p.sh. emetimet PM).

2.3 Energjia, veprimet do të kontribuojnë në promovimin e efikasitetit të energjisë.

### **Connected**

3.1. Transporti: veprimet do të synojnë zhvillimin e mobilitetit të qëndrueshëm, të qëndrueshëm ndaj klimës, inteligjent dhe ndërmodal kombëtar, rajonal dhe lokal, përfshirë përmirësimin e aksesit në TEN-T dhe mobilitetin ndërkufitar, përmes masave të buta.

### **Social**

4.1. Aftësitë: Veprimet do të synojnë përmirësimin e shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe cilësore në arsim, trajnim dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës përmes veprimeve ndërkufitare me qëllim rritjen e niveleve të aftësive.

4.2. Turizmi gjithëpërfshirës: Forcimi i rolit të kulturës dhe turizmit në zhvillimin ekonomik, përfshirjen sociale dhe inovacionin social, përmes veprimeve ndërkufitare.

### **Buxheti dhe Kohëzgjatja**

Thirrja financon projekte standarde, buxheti i të cilave do të variojë nga 600,000 € deri në 1,500,000 € (IPA + Bashkëfinancimi Kombëtar për projekt, me një kohëzgjatje jo më të gjatë se 30 muaj dhe jo më të shkurtër se 18 muaj).

Shpërndarja e Buxhetit sipas Akseve Prioritare:

Aksi 1 (Smart): IPA Funds 7.753.235,10 | National Co-financing € 1.645.764,90

Total € 9.399.000,00 €

Aksi 2 (Green): IPA Funds € 13.071.365,40 | National Co-financing € 2.774.634,60

Total € 15.846.000,00

Aksi 3 (Connected): IPA Funds € 4.273.806,90 | National Co-financing € 907.193,10

Total € 5.181.000,00

Aksi 4 (Social): IPA Funds € 6.525.783,90 | National Co-financing € 1.385.216,10

Total € 7.911.000,00

Aksi 5 Governance: IPA Funds € 0,00 | National Co-financing € 0,00

Total € 0,00

Buxheti total i thirrjes: 38,337,000 euro

### **Bashkëfinancimi**

Edhe pse, në nivel programi, norma e bashkëfinancimit IPA është 82,49%, normat e mëposhtme janë të zbatueshme:

- Për partnerët italianë 80%;
- Për partnerët shqiptarë dhe malazezë 85%.

Për partnerët italianë publikë dhe privatë, bashkëfinancimi u ngaratohet nga shteti italian në përputhje me vendim CIPESS n. 78/2021.

Për partnerët shqiptarë dhe malazezë do të kryejnë bashkëfinancimin kombëtar prej 15% në nivel partneri.

**Aplikantët e synuar:**

- Organizma publike
- Organizma të qeverisur nga e drejta publike
- Organizata private jofitimprurëse

**Zonat e synuara:** Italia (rajonet Puglia dhe Molise), i gjithë territori i Shqipërisë dhe Malit të Zi

**Kriteret e pranueshmërisë për aplikantët:**

- Të jenë të vendosur në zonat e pranueshme të programit
- Të kenë statusin ligjor të kërkuar (publik, i qeverisur nga e drejta publike, jofitimprurës)
- Organizatat jofitimprurëse duhet të jenë operative dhe të regjistruara për të paktën 24 muaj

**Kostot e pranueshme:**

- Kostot e personelit
- Kostot e ekspertizës dhe shërbimeve të jashtme
- Kostot e pajisjeve
- Kostot e infrastrukturës dhe punimeve
- Normë e sheshtë për shpenzime zyre dhe administrative
- Normë e sheshtë për udhëtime dhe akomodim

Kostot e papranueshme: Nuk specifikohen në thirrje, por duhet të respektohen rregullat e programit dhe BE-së.

Sqarimet ose pyetjet mund të bëhen me email në [js@southadriatic.eu](mailto:js@southadriatic.eu) dhe përgjigjet do të publikohen në dokumentin FAQ.

**Afati i fundit për aplikim:** 30 shtator 2024 në orën 11.59.

**Link i thirrjes:** <https://www.italy-albania-montenegro.eu/programme/south-adriatic-2021-27/south-adriatic-calls>